



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË
V E N D I M

Nr. 32 dt.08.05.1995

PER
EMERIMIN E DREJTORIT TE FABRIKES SE SHKREPSES
TE KESHILLIT DREJTUES DHE PAGES SE TYRE

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e dt.08.05.1995, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Seksioni i Prognozës, për ndarjen e ish fabrikës së Shkrepses, të emërimit të Drejtoreshës së Fabrikës së Shkrepses “mëmë”, të Këshillit Drejtues dhe pagës tyre, mbështetur në kompetencë që i jep këtij Këshilli ligji “Për Ndërmarrjet Shtetërore” Nr.7582, dt.13.07.1992 dhe ligji “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”Nr.7574, dt.10.06.1992

VENDOSI

1. Ndarja e Fabrikës së Shkrepses në dy ndërmarrje :
 - 1.Fabrika e Shkrepses
 - 2.Ndërmarrja e Përbashkët “Bastuneria e Re Shqiptare”
2. Emërimin e Z.Fatmira Dosti, Drejtoreshë e Fabrikës së Shkrepses, Z.Majlinda Duke anëtare e Këshillit Drejtues, Z.Eliverta Mice anëtare e Këshillit Drejtues.
3. Paga e Drejtoreshës vendoset 7.000 lekë në muaj, kurse e antarëve të Këshillit paga mujore vendoset 12 – 20

përqind më e vogël se paga e drejtoreshës.

KRYETARI

BESNIK PETRELA